



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 25.09.19 Ref.: 1781/190

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 77-të të mbajtur më 16.07.2019 mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa e Universitetit të Gjakovës “Fehmi Agani”, Nr. 859/19H, datë 30.05.2019 për riakreditim të programit të studimit:
 - Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS
- II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

I. Universiteti i Gjakovës “Fehmi Agani” ka parashtruar kërkesë (kërkesa Nr. 859/19H, datë 30.05.2019) pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programit të studimit: Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS.

Bazuar në nenin 10 të Udhëzimit Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Nr. 15/2018, datë 28.09.2018 (tash e tutje UA për Akreditim), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC) në mbledhjen e mbajtur me 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e Universitetit të Gjakovës "Fehmi Agani" (tash e tutje Universiteti).

Bazuar në pikën 1.2 të Neni 10 të UA për Akreditim, ku thuhet, *"Në përputhje me kërkesat e këtij udhëzimi administrativ, KShC do të bëjë aprovimin e listës së stafit akademik për çdo program të studimit i cili parashtrohet për aplikim nga institucionet e arsimit të lartë. Tabelat e plotësuara në formë elektronike së bashku me deklaratat për angazhimin e stafit akademik përcillen në formë të raportit përmbledhës në mbledhjen e ardhshme të KShC-së për aprovim formal. Raporti përmbledhës për gjendjen e stofit në bazë të të dhënave të dorëzuara nga institucionet e arsimit të lartë përgatitet nga stafi i AKA-së"*, KShC erdhi në përfundim se programi i studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS, nuk i plotëson kushtet ligjore për aprovim.

Bazuar në Nenin e referuar më lartë, KShC në mbledhjen e mbajtur më 16 shtator 2019 ka trajtuar aplikacionin e dorëzuar nga ky Universitet. Sipas të dhënave të prezantuara nga raporti përmbledhës për programin me të cilin ka aplikuar ky institucion, dhe pas analizimit të detajuar të dokumentacionit të prezantuar nga ky institucion për stafin akademik, në mungesë të stafit akademik të fushës së programit të studimit, ashtu siç parashihet me Nenin 26, pika 5.3.4 e UA për Akreditim, dhe bazuar në Nenin 10, pika 1.3.2, KShC mori vendim për refuzim të aprovimit të aplikacionit për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS.

Si bartës për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS, Universiteti ka paraparë: Shqipe Husaj (PhD në Shkenca Sociale profili Psikologji), Laura Naka (PhD në Shkenca Filologjike profili Gjuhë dhe Letërsi Angleze) dhe Labinot Berisha (PhD në Letërsi).

Sipas paragrafit të fundit të Nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, kërkohet që: *"për çdo 60 ECTS kredi të programit të studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit"*. Pas verifikimit të dokumentacionit ashtu sic është përcaktuar me Udhëzimin Administrativ 15/2018, KShC ka konstatuar se vetëm njëri nga tre bartësit e paraparë nga Universiteti për këtë program mban titullin PhD në fushën e programit të studimit. Znj. Shqipe Husaj dhe Z. Labinot Berisha nuk mund të jenë bartës të programit të studimit, pasi që nuk plotësojnë kriteret e parapara me Nenin 26 të UA për Akreditim.

Bazuar në faktet e prezantuara me sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KShC vendosi që në mungesë të stafit të fushës së programit të studimit, dhe bazuar në Nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të refuzoj aprovimin e aplikacionit për programin e studimit Gjuhë dhe Letërsi Angleze, BA, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit të Komisionit të Ankesave të AKA-së, sipas Rregullores nr. 2/2019, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Gjakoves "Fehmi Agani"
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

